



KOMUNIKATË

31.10.2009

Në mbledhjen e 49-të me radhë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar agjendën e aktiviteteve dhe detyrave që lidhen me procesin zgjedhor. Anëtarët e KQZ-së, kanë miratuar raportin e mbledhjes nr. 43/2009. Kryetarja e KQZ znj. Nesrin Lushta, ka informuar anëtarët e KQZ-së se, u është dërguar ftesë Komisioneve Zgjedhore të Shqipërisë, të Maqedonisë, të Bosnjes dhe të Malit të Zi për t'i vëzhguar zgjedhjet e 15 Nëntorit.

Në vazhdim të mbledhjes, Miradie Mavriqi, drejtoresha e Zyres për Regjistrimin e Partive Politike, paraqiti rekomandimet për akreditim të vëzhguesëve që kanë aplikuar për t'i vëzhguar zgjedhjet. Deri më 30 tetor, janë proceduar aplikacionet e nëntë (9) subjekteve politike, të dy (2) organizatave ndërkombëtare, dhe të tri (3) ambasadave. Kurse për ditën e zgjedhjeve, kanë aplikuar të akreditohen një (1) subjekt politik dhe një (1) OJQ vendore. Rekomandimet e Zyres, janë bërë për 3.551 vëzhgues.

KQZ ka aprovuar rekomandimet e ZRPP-së. Numri i vëzhguesëve të akredituar deri më sot nga KQZ, ka arritur në 19.576 vëzhgues.

Alban Muriqi nga Zyra Ligjore, ka informuar KQZ-ë për 11 ankesa të parashtruara në KQZ nga subjektet e ndryshme politike që kanë të bëjnë me problemet që lidhen me Këshillat e Vendnumrimeve, me tërheqjet nga nominimet e kandidatëve prej procesit zgjedhor etj. KQZ e ka dëgjuar raportin lidhur me ankesat por, gjithashtu ka dëgjuar edhe përgjigjet ligjore që i ka dhënë Zyra Ligjore lidhur me këto ankesa. KQZ është pajtuar që shyrtime të bëra të mbesin siq janë, por ka kërkuar që ankesat eventuale që janë për KZAP-in t'i dërgohen atij, kurse të tjerat ankesa që mund të kenë precedane penale t'u dërgohen prokurorive gjegjëse. KQZ ka kërkuar nga ZL që nëse ka edhe ankesa të tjera, ato të sillen sa më shpejt në KQZ.

Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, ka informuar lidhur me përgatitjet që janë duke u bërë në Qendren e Numrimit. Anëtarët e KQZ kanë shtruar shumë pyetje lidhur me QNR-në siq është cshtja e gjeneratorëve, ajo e telefonave fiks, çështja e kujdestarisë etj. Kryeshefi Peqani, ka thënë se QNR do të fillojë trajnimet të martën e ardhshme dhe se, gjithçka do të jetë në rregull. Kur është fjala për energjinë elektrike, KQZ ka kërkuar që të bëhen takime me përfaqësues të KEK-ut në mënyrë që në kohën e zgjedhjeve, asesi të mos ketë reduktime të energjisë në zonën ku është e vendosur QNR.

Në mbledhjen e sotshme, KQZ ka aprovuar vendimet që të emërohen Zyrtarët e KKZ-ve në Graçanicë dhe Zveçan deri në shpalljen dhe materializimin e konkursit, në mënyrë që të mos ketë vakum institucional në këto dy komuna.